

Në vijim të komunikimit me institucionin tuaj në lidhje me procesin e informimit publik për vendimet e Këshillit Kombëtar të Territorit, po ju parashtrijmë qëndrimet tona të bazuara në ligj dhe në rrethanat specifike:

Së pari referuar Vendimit Nr. 519 të Këshillit të Ministrave, datë 20.9.2017 "Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit", i ndryshuar, KKT është **organ kolegjial** dhe ka përbërjen sic citohet më poshtë:

1. Këshilli Kombëtar i Territorit, si autoritet kombëtar i planifikimit dhe zhvillimit të territorit,

kryesohet nga Kryeministri dhe ka në përbërje:

- *Ministrin e Infrastrukturës dhe Energjisë anëtar;*

- *Ministrin e Financave dhe Ekonomisë anëtar;*

- *Ministrin e Drejtësisë anëtar;*

- *Ministrin e Kulturës anëtar;*

- *Ministrin e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural*

anëtar;

- *Ministrin e Turizmit dhe Mjedisit anëtar;*

- *Ministrin e Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes*

anëtar;

- *Drejtorin e Përgjithshëm të Agjencisë së Zhvillimit të Territorit anëtar dhe sekretar.*

Së dyti referuar pikës 1 të Nenit 3 të Ligjit Nr. 90/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore", funksionimi i AZHT **U nënshtrohet parimit të hierarkisë së administratës shtetërore**:

Neni 3

Parimet e organizimit dhe funksionimit të administratës shtetërore

1. Administrata shtetërore organizohet dhe funksionon sipas parimeve të: unitetit dhe hierarkisë;

Sa më sipër dhe referuar Vendimit Nr. 725, datë 02.09.2015, të Këshillit të Ministrave "Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Agjencisë së Zhvillimit të Territorit" të ndryshuar, Këshilli i Ministrave ka vendosur krijimin e Agjencisë së Zhvillimit të Territorit (AZHT), e cila aktualisht funksionon si Sekretariat Teknik i Këshillit Kombëtar të Territorit (KKT), dhe në përputhje me parimin ligjor të sipërcituar AZHT nuk mund të detyrojë autoritete publike që në shkallë hierarkike qëndrojnë më lart, të përshpejtojnë procese të lidhura me nënshkrimin nga autoritetet e sipërcituara.

Në përputhje me parashikimet e Vendimit Nr. 519 të Këshillit të Ministrave, datë 20.9.2017 "Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit", i ndryshuar, AZHT ka dërguar për nënshkrim brenda afatit të parashikuar në këtë VKM në çdo rast tek autoritetet publike që janë anëtarë të KKT. Pas firmosjes bëhet publikimi në faqen zyrtare të institucionit.

Në zbatim të Ligjit 119/2014 "Për të drejtën e Informimit", datë 18.9.2014, të direktivave të Bashkimit Europian dhe angazhimit të Qeverisë Shqiptare për shërbimin ndaj qytetarëve në procesin e informimit publik e në përputhje

me qëllimin për tu ardhur në ndihmë të gjithë qytetarëve për të gjetur me lehtësi informacione me karakter publik të administruara nga autoriteti publik-Agjenca e Zhvillimit të Territorit, kemi qenë dhe vazhdojmë të jemi në dispozicion për realizimin e kërkesave të ligjshme të entiteve publike apo private.

Duke Ju falenderuar për mirëkuptimin

Informacioni i transmetuar në përmbajtje të këtij mesazhi është i destinuar vetëm për individin ose për Institucionin të cilit i është nisur, mund të përmbajë materiale konfidenciale dhe / ose të privilegjuara vetëm për marrësin. Çdo rishikim, transmetim, shpërndarje apo kryerje e ndonjë veprimi tjetër të ngjashëm me këto, nga personat apo nga subjekte të tjera të ndryshme nga marrësi i synuar, është ndaluar. Nëse merrni gabimisht këtë mesazh, ju lutem kontaktoni urgjentisht dërguesin e tij dhe fshini çdo material të transmetuar në kompjuterin tuaj. Ne nuk pranojmë asnjë detyrim lidhur me dëmtimin apo humbjen e shkaktuar nga programe të dëmshme apo nga viruse, përveç rastit të neglizhencës së plotë, apo sjelljes së gabuar dhe të qëllimshme.

The information transmitted in the content of this message is intended only for the individual or the institution to whom it is addressed, may contain confidential and/or privileged material for the recipient only. Each review, transmission, distribution or performance of any other action similar to these, by persons or by entities other than the intended recipient, is prohibited. If you receive this message in error, please contact the sender immediately and delete any transmitted material on your computer. We do not accept no liability related to damage or loss caused by harmful programs or viruses, except in the event of gross negligence, or willful misconduct